



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH**

**Udhëzim Administrativ Nr.05/2012 Mbikëqyrja Etike Profesionale**

**Administrative Instruction No.05/2012 Supervision of Professional Ethics**

**Administrativno Uputstvo Br.05/2012 Nadzor Profesionalne Etike**

Ministria e Shëndetësisë	Ministry Of Health	Ministartvo Zdravstva
<p>Në mbështetje të nenit 93 (paragrafi 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;</p> <p>Duke u bazuar në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor nr.2004/38</p> <p>Duke marrë parasysh nenin 38 paragrafi 2 dhe 6 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011 dhe nenin 8 e Shtojcën 9 të Rregullores nr.02/11 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive nxjerr:</p>	<p>Pursuant to Article 93 (paragraph 4) of the Constitution of the Republic of Kosovo;</p> <p>Based in the Law on the Rights and Responsibilities of the Citizens in the Health Care No 2004/38</p> <p>Considering Article 38 paragraph 2 and 6 of the Rules of Procedure of the Republic of Kosovo Nr.09/2011 and Article 8 of Annex 9 of the Regulation for Areas of Responsibility nr.02/11 Administrative Office of the Prime Minister and ministries issues:</p>	<p>Na osnovu člana 93 ( paragraf 4)Ustava Republike Kosova;</p> <p>U skladu sa Zakonom o pravima i odgovornostima građana u zdravstvenoj zaštiti br.. 2004/38;</p> <p>Uzimajući u obzir član 38. stav 2. i 6. Pravilnika o radu Vlade Republike Kosova br. 09/2011 i član 8 Aneksa 9. Pravilnika br.02-11 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije Premijera i ministarstava, donosi:</p>
<p align="center"><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV (SHËNDETËSI) Nr. 05/2012 MBIKËQYRJA ETIKE PROFESIONALE</b></p> <p align="center"><b>Qëllimi Neni 1</b></p>	<p align="center"><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (HEALTH) NO.05/2012 SUPERVISION OF PROFESSIONAL ETHICS</b></p> <p align="center"><b>Purpose Article 1</b></p>	<p align="center"><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (O ZDRAVSTVU) BR.05/2012 O NADZORU PROFESIONALNE ETIKE</b></p> <p align="center"><b>Cilj Član1</b></p>
<p>Me këtë udhëzim administrativ rregullohet organizimi dhe funksionimi i mbikëqyrjes etike profesionale të profesionistëve shëndetësorë dhe hulumtuesve shkencor në lëmitë bio-mjekësore, që ka për qëllim ruajtjen e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe mbrojtjen e pacientëve e publikut nga keq ushtrimi i profesionit mjekësor përfshirë hulumtimet profesionale dhe shkencore në njerëz.</p>	<p>Administrative Instruction shall regulate the organization and functioning of professional ethical Monitoring of health professionals and scientific researchers in bio-medical fields, aimed at maintaining high standards in establishing and practicing of medical profession and protection of the patients and public from bad practice of medical profession including professional and scientific research on humans.</p>	<p>Ovim administrativnim uputstvom reguliše se organizacija i funkcioniranje nadzora profesionalne etike zdravstvenih stručnjaka i naučnih istraživača u bio-medicinskim oblastima, u cilju održavanja visokih standarda u uspostavljanju i obavljanju lekarske profesije i zaštite pacijenata i stanovništva od lošeg obavljanja lekarske prakse, uključujući stručno i naučno istraživanje na ljudima.</p>

<p align="center"><b>Fusha e zbatimit Neni 2</b></p>	<p align="center"><b>Field of application Article 2</b></p>	<p align="center"><b>Oblast sprovođenja Član 2</b></p>
<p>Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ zbatohen për të gjitha institucionet dhe të gjithë profesionistët shëndetësorë dhe bashkëpunëtorët shëndetësorë në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, në sektorin publik, privat, dhe publiko-privat.</p>	<p>The provisions of this Administrative Instruction shall apply to all institutions and all health professionals and health associates at all levels of health care, public sector, private, and public-private.</p>	<p>Odredbe ovog Administrativnog uputstva primenjuju se za sve institucije i zdravstvene radnike i saradnike na svim nivoima zdravstvene zaštite, javnog i privatnog kao i javno –privatnog sektora.</p>
<p align="center"><b>Nivelet Neni 3</b></p>	<p align="center"><b>Levels Article 3</b></p>	<p align="center"><b>Nivoa Član 3</b></p>
<p>1. Mbikëqyrja etike dhe profesionale organizohet në dy shkallë.</p> <p>2. Shkalla e parë e mbikëqyrjes përfaqësohet me Komisionet Etike dhe Profesionale në nivel të:</p> <p>2.1 Drejtorive Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe Drejtorive të institucioneve shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik, privat dhe publiko-privat.</p> <p>3. Shkalla e dytë e mbikëqyrjes përfaqësohet me Bordin Qendror Etik dhe Profesional të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë (në tekstin e mëtejme, Bordi).</p>	<p>1. Ethical and professional supervision is organized in two stages.</p> <p>2 The first stage of monitoring is represented by Ethics commissions and Professional in the following level:</p> <p>2.1 Municipal Departments of Health and Social Welfare, and the Departments of health institutions in the secondary and tertiary health care in the public sector, private and public-private.</p> <p>3. The second degree of monitoring represented by the Central Board of Professional Ethics and appointed by the Minister of Health (hereinafter the Board).</p>	<p>1. Nadzor profesionalne etike organizira se u vidu dva stepena.</p> <p>2. Prvi stepen nadzora zastupa se od strane Komisije profesinalne etike na nivou:</p> <p>2.1 Opštinskih direkcija za zdravstvo i socijalno staranje kao i Direkcija zdravstvenih institucija sekundarne i tercijarne zdravstvene zaštite, javnog i privatnog kao i javno –privatnog sektora.</p> <p>3. Drugi stepen nadzora zastupljen je od Centralnog odbora profesionalne etike, koju imenuje Ministar Zdravstva (daljem tekstu Odbor ).</p>
<p align="center"><b>Misioni dhe Organizimi i Komisioneve Etike Profesionale Neni 4</b></p>	<p align="center"><b>Mission and Organization of Professional Conduct Committees Article 4</b></p>	<p align="center"><b>Misija i organizacija Komisija za Profesionalnu Etiku Član 4</b></p>